

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar**

**P5**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

*Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme!*

Data 23.06.2024

1. Më poshtë janë draft pasqyrat e pozitës financiare të Naim sh.a, Sami sh.a dhe Abdyl sh.a më 31 dhjetor 2023:

	Naim sh.a €'000	Sami sh.a €'000	Abdyl sh.a €'000
<b>Pasuritë</b>			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Prona, fabrika dhe paisjet	800	600	350
Investimet	<u>100</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
	900	600	350
<i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet	200	60	80
Llogaritë e arkëtueshme	114	85	47
Paraja	<u>75</u>	<u>22</u>	<u>27</u>
	<u>389</u>	<u>167</u>	<u>154</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>1,289</b>	<b>767</b>	<b>504</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
<i>Ekuiteti</i>			
Aksionet e zakonshme prej €0.50 secila	300	250	200
Premia e aksioneve	126	102	90
Fitimet e mbajtura	<u>175</u>	<u>(30)</u>	<u>72</u>
	601	322	362
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Kredia bankare	400	300	100
<i>Detyrimet afatshkurta</i>			
Të pagueshmet tregtare	<u>288</u>	<u>145</u>	<u>42</u>
	<u>688</u>	<u>445</u>	<u>142</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>1,289</b>	<b>767</b>	<b>504</b>

**Informacioni i mëposhtëm është i rëndësishëm në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara.**

- i) Naim sh.a bleu 60% të aksioneve të ekuiteit të Sami sh.a më 1 janar 2022 për një shumë prej €300,000 të pagueshme më 31 dhjetor 2024. Premia e aksioneve dhe fitimet e pashpërndara ishin €102,000 dhe €5,000 respektivisht në atë datë. Vlera e drejtë e pasurive neto në blerje ishin të barabarta me vlerën e tyre kontabël me përjashtim të një zëri të fabrikës. Vlera e drejtë e fabrikës ishte mbi vlerën kontabël të saj për €10,000. Ajo kishte një jetë të dobishme ekonomike të mbetur prej 5 vjetësh në datën e blerjes. Rregullimi i vlerës së drejtë nuk është përfshirë në pasqyrat e mësipërme të pozitës financiare.
- ii) Naim sh.a bleu 40% të aksioneve të ekuitetit të Abdyl sh.a më 31 dhjetor 2022 për një shumë prej €95,000. Premia e aksioneve dhe fitimet e pashpërndara ishin përkatësisht €90,000 dhe €35,000 në atë datë. Vlera e drejtë e pasurive neto në momentin e blerjes ishte e barabartë me vlerën e tyre kontabël.
- iii) Naim sh.a ka kosto kapitali prej 10%. Faktorët e skontimit më poshtë janë relevant:

Viti	FS @10%
1	0.909
2	0.826
3	0.751

- iv) Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2023, Sami sh.a i shiti mallrat Naim sh.a-së për €20,000. Mallrat i kushtuan Sami sh.a-së €15,000 për tu blerë. 20% e këtyre mallrave ishin ende në stoqet e Naim sh.a-së. Deri me 31 dhjetor 2023. Naim sh.a ende nuk ia kishte paguar Sami sh.a-së shumën prej €20,000.
- v) Sami sh.a dhe Abdyl sh.a nuk kanë emetuar asnjë aksion shtesë që kur u blenë nga Naim sh.a.
- vi) Investimi në Abdyl sh.a është paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare të Naim sh.a-së me kosto. Investimi në Sami sh.a **nuk** është përfshirë në pasqyrat e Naim sh.a. Investimet e tjera janë investime në ekuitet në entitetet tjera jashtë grupit dhe përfaqësojnë më pak se 10% të ekuitetit në ato entitete.
- vii) Me 31 dhjetor 2023 është kryer një test i dëmtimit dhe rezultoi në një dëmtim të zërit të mirë në Sami sh.a për €2,000. Investimi në Avdyl sh.a ishte dëmtuar për €4,000.
- viii) Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së plotë (të drejtë). Vlera e drejtë e interesit jo kontrollues në Sami sh.a më 1 janar 2022 ishte €150,000.

**Kërkohet:**

**Përgatiteni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Naim sh.a më 31 dhjetor 2023.**

**(20 pikë)**

**Zgjidhje detyra 1**  
**Grupi Naim sh.a**

	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë</b>	
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (800+600+10-4L11)	1,406.00
Investimi në shoqëri L13	105.80
Investimet tjera (100-95)	5.00
Zëri i mirë L11	<u>6.30</u>
	1,523.10
 <i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet (200+60-1FPR L14)	259.00
Llogaritë e arkëtueshme (114+85-20)	179.00
Paraja (75+22)	<u>97.00</u>
	<u>535.00</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>2,058.10</b>
 <b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>	
<i>Ekuiteti</i>	
Aksionet e zakonshme prej €0.50 secila	300.00
Premia e aksioneve	126.00
Fitimet e mbajtura L14	113.29
Interesat jo-kontrollues L15	<u>133.20</u>
	672.49
 <i>Detyrimet afatgjata</i>	
Kredia bankare (400+300)	700.00
Konsidertata e shtyrë (L12)	272.61
 <i>Detyrimet afatshkurta</i>	
Të pagueshmet tregtare (288+145-20)	<u>413.00</u>
	<u>1,385.61</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>2,058.10</b>
 <b>L11 Zëri i mirë</b>	<b>€'000</b>
Sami sh.a	
Konsto e investimit 300 x 0.751	225.30
Vlera e drejtë e interesave jo kontrolluese	<u>150.00</u>
	375.30
 Minus vlera e drejtë e pasurive neto të blera:	
Aksionet e ekuitetit	250.00
Premia e aksioneve	102.00
Fitimet e mbajtura	5.00
Korigjim i VD – Fabrika	<u>10.00</u>
Vlera e drejtë e pasurive neto të blera	<u>(367.00)</u>
Zëri i mirë në datën e blerjes	8.30
Minus: dëmtimi	<u>(2.00)</u>
<b>Zëri i mirë në datën e raportimit</b>	<b>6.30</b>

Zhvlerësimi shtesë në korigjimin e VD (10 / 5 vite x 2 vite) = 4

<b>L12 Konsiderata e shtyrë</b>	<b>€'000</b>
Vlera e tanishme me 1 janar 2023 L11	225.30
Anunlimi i skontimit (viti 1 225.3 x10%)	22.53
Anunlimi i skontimit (viti 2 (225.3 +22.53) x10%)	<u>24.78</u>
<b>Vlera me 31 dhjetor 2023</b>	<b>272.61</b>

<b>L13 Investimi në shoqëri</b>	<b>€'000</b>
Kosto e investimit	95.00
Pjesa e fitimeve pas blerjes L14	14.80
Minus dëmtimi	<u>(4.00)</u>
<b>Me 31 dhjetor 2023</b>	<b>105.80</b>

<b>L1 4 Fitimet e mbajtura</b>			<b>€'000</b>
	<b>Naim sh.a</b>	<b>Sami sh.a</b>	<b>Avdyl sh.a</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Sipas pyetjes	175.00	(30)	72
Para blerjes	<u>-</u>	<u>5</u>	<u>35</u>
Pas blerjes	175.00	(35)	37
Zhvlerësimi shtesë		(4)	
Fitimi i përealizuar ((20-15) x 20%)		(1)	
Dëmtimi i zërit të mirë		<u>(2)</u>	
		(42)	
Pjesa e fitimit të shoqërisë (37) x 40%	14.80		
Pjesa e humbjeve të degës (42) x 60%	(25.20)		
Anulimi i skontimit (22.53+24.78 L13)	(47.31)		
Dëmtimi i investimit në shoqëri	<u>(4.00)</u>		
<b>Me 31 dhjetor 2023</b>	<b>113.29</b>		

<b>L15 Interesat jo-kontrollues</b>	<b>€'000</b>
Sipas VD në blerje	150.00
Pjesa e humbjeve pas blerjes (40% x -42 L14)	<u>(16.80)</u>
	<b>133.20</b>

2.

a) Më 1 nentor 2023 Naum Veqilharxhi sh.a i kishte shitur me para një klienti një makinë prodhimi për €150,000 duke përfshirë shërbime të mbështetjes teknike për 12 muaj. Kur shiten veçmas nga Naum Veqilharxhi sh.a, shërbimet e mbështetjes teknike kanë një marzhë mbi kosto prej 50%. Naum Veqilharxhi sh.a-së do t'i kushtojë €40,000 për të ofruar shërbime të mbështetjes teknike për 12 muaj. Makina e prodhimit zakonisht shitet për €130,000 pa mbështetje teknike.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni me llogaritjet mbështetëse se si ky transaksion duhet të kontabilizohet në pasqyrat financiare të Naum Veqilharxhi sh.a-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 në përputhje me kërkesat e SNRF 15 *Të ardhurat nga kontratat me klientët*. (5 pikë)**

b) Objektivi i SNK 20 *Kontabiliteti për grante qeveritare dhe shpalosja e ndihmës qeveritare* është të përshkruajë kontabilitetin dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të granteve qeveritare dhe formave të tjera të ndihmës qeveritare.

Ndre Mjeda sh.a mori një grant qeveritar prej €10 milion më 1 janar 2023 për të mbuluar 40% të koston e një makinerie të re që kushtoi €25 milion. Makinaria u ble në të njëjtën datë kur u mor granti. Makinaria kishte një jetë të dobishme ekonomike 5 vjet në momentin e blerjes me vlerë të mbetur zero. Ndre Mjeda sh.a përdor metodën e të ardhurave të shtyra për të kontabilizuar grantet e lidhura me pasuritë.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni trajtimin e kërkuar kontabël të grantit qeveritar në pasqyrat financiare të Ndre Mjeda sh.a-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 dhe tregoni ekstraket e pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe pasqyrës së pozitës financiare. (5 pikë)**

(c) Objektivi i SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese* është të përcaktojë kur një entitet duhet të korrigjoj pasqyrat e saj financiare për ngjarjet pas periudhës raportuese dhe dhënien e informacioneve shpjeguese që një entitet duhet të shpalos në lidhje me datën kur pasqyrat financiare janë autorizuar për publikim dhe rreth ngjarjeve pas periudhës raportuese.

**Kërkohet:**

(i) **Tregoni dallimin midis ngjarjeve korrigjuese dhe jo-korrigjuese. (2 pikë)**

(ii) **Tregoni trajtimin kontabël të një ngjarje korrigjuese dhe një ngjarje jo-korrigjuese. (2 pikë)**

(iii) **Jepni dy (2) shembuj të ngjarjeve korrigjuese. (1 pikë)**

d) Zef Jubani sh.a është një kompani që shet materiale ndërtimi. Numërimi i stoqeve për pllakat e betonit është bërë në ditën e fundit të muajit me 31 dhjetor 2023 ndërsa ai i tullave më 4 janar 2024. Më poshtë janë aktivitetet që lidhen me secilin lloj të stoqeve.

Pllakat e betonit: Kanë qenë 1,200 pllaka betoni me një kosto prej €5.00 secila. Gjatë muajve janar dhe shkurt 2024 pllakat e betonit janë shitur me €4.00 secila dhe punëtorëve iu është dhënë një komision prej 10% mbi shitjet totale.

Tullat: Vlera në libra e tullave ishte €24,000 më 4 janar 2024. Ndërmjet 31 dhjetorit 2023 dhe 4 janarit 2024 u blenë tulla me një kosto prej €3,600 dhe shitjet e tullave arritën në €7,200. Zef Jubani sh.a shton një marzhe mbi kosto prej 20% për të arritur në çmimin e shitjes për tullat.

**Kërkohe:**

**Llogaritni në përputhje me kërkesat e SNK 2 *Stoqet*, vlerën totale të stoqeve që Zef Jubani sh.a do ta raportoj në pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2023 si për pllakat e betonit ashtu edhe për tullat.** (5 pikë)

**[Total: 20 pikë]**

## Zgjidhje detyra 2.

a) Të ardhurat do të ndahen si në vijim:

Kosto e shërbimit plus marzha  $40,000 + 20,000 = 60,000$

Çmimi i makinerisë si e vetme plus kosto e shërbimit  $130,000 + 60,000 = 190,000$

Të ardhurat e alokuara tek makina e prodhimit

$130,000 / 190,000 \times 150,000 = 102,630$

Të ardhurat e alokuara tek shërbimi

$60,000 / 190,000 \times 150,000 = 47,370$

Të hyrat për vitin e përfunduar deri me 31 dhjetor 2023

Të hyrat nga shitja e makinerisë 102,630

Të hyrat nga ofrimi i shërbimeve të mbështetjes teknike  $(47,630/12 \times 2)$  7,938

Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2023

Të hyrat e shtyera  $(47,370 - 7,938)$  39,432

b)

Metoda e përdorur është e ardhura e shtyrë. Kjo do të thotë që granti do të njihet gjatë jetës së një pasurie si të ardhura në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Kjo shkon në €2 milion (€10 milion / 5 vjet jetë e dobishme e makinerisë) të ardhura nga granti i kredituar në fitim ose humbje për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023.

Shpenzimet e zhvlerësimit për të njëjtën periudhë do të jenë €5 milion (€25 milion / 5 vjet) debitohet në fitim ose humbje.

Në pasqyrën e pozitës financiare, një detyrim afatgjatë prej €6 milion dhe një detyrim afatshkurtë prej €2 milion do të njihet më 31 dhjetor 2023.

### Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 (ekstrakt)

€'000

Të ardhura nga granti

2,000

Shpenzimet e zhvlerësimit

(5,000)

### Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2023 (ekstrakt)

€'000

*Pasuritë*

Makineria

20,000

*Detyrimet afatgjata*

Të ardhurat e shtyera

6,000

*Detyrimet afatshkurta*

Të ardhurat e shtyera

2,000



**(c) SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese**

*(i) Tregoni dallimin midis ngjarjeve korigjuese dhe jo-korigjuese*

Ngjarjet korigjuese janë ato ngjarje, të favorshme ose të tjera që ofrojnë informacion shtesë për atë që ekzistonte në datën e raportimit. Prandaj ato përdoren për korigjimin e pasqyrave financiare.

Ndërsa ngjarjet jo-korigjuese nuk japin informacion shtesë për atë që ekzistonte në datën e raportimit. Prandaj, ato thjesht shpalosen në pasqyrat financiare.

*(ii) Tregoni trajtimin kontabël të një ngjarje korigjuese dhe një ngjarje jo-korigjuese*

SNK 10 kërkon që shumat e njohura në pasqyrat financiare të korigjohen për të marrë parasysh një ngjarje korigjuese. Standardi kërkon gjithashtu që informacionet shpjeguese të korigjohen duke marrë parasysh informacionin e ri që lidhet me një gjendje që ekzistonte në datën e raportimit.

SNK 10 ndalon korigjimin e shumave të njohura në pasqyrat financiare për të pasqyruar ngjarjet jokorigjuese pas datës së raportimit. Megjithatë, nëse një ngjarje jo-korigjuese është materiale dhe mosshpalosja e saj mund të ndikojë në vendimet e përdoruesve, atëherë një entitet duhet të japë informacione shpjeguese.

*(iii) Jepni dy (2) shembuj të ngjarjeve korigjuese*

Ngjarjet korigjuese, siç duket edhe nga emri, kërkojnë korigjime në pasqyrat financiare. Më poshtë janë disa shembuj:

- Dëshmi e një zvogëlimi permanent të vlerës së pronës para perfundimit të vitit
- Shitja e stoqeve pas periudhës raportuese për më pak se vlera bartëse në fund të vitit
- Jo-solventiteti i një klienti me një saldo borxhi në fund të vitit
- Shumat e pranuar apo paguara lidhur me kërkesat ligjore ose për sigurim të cilat ishin në negociata në fund të vitit
- Përcaktimi para perfundimit të vitit i çmimit blerës apo shitës i pasurive të shitura apo të blera para perfundimit të vitit
- Dëshmi e një zvogëlimi permanent të vlerës së një investimit para perfundimit të vitit
- Zbulimi gabimit apo mashtrimit që tregon se pasqyrat financiare kanë qenë të pasakta

**d) Llogaritja e stoqeve:**

Pllakat e betonit:

Kosto 1,200 x €5.00 = €6,000

Vlera neto e realizueshme VNR: Shitja 1,200 x €4.00 = €4,800

Komisioni 10% x 4,800 (€480)

VNR €4,320

VNR e cila është më e ulët se kosto do të jetë kosto e stoqeve me 31 dhjetor 2023.

Tullat:

Blerjet = €3,600

Shitjet = €7,200

Marzha mbi kosto  $20/120 \times €7,200$  (€1,200)

Kosto e shitjeve €6,000

Rregullimi i stoqeve në shumën që ekzistonte më 31 dhjetor 2023

$24,000 + 6,000 - 3,600 = €26,400$

Prandaj, vlerësimi total i stoqeve në fund të vitit 2023 ishte

Pllakat e betonit €4,320 + tullat €26,400 = €30,720

3.

(a) Në vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023, Asdreni sh.a realizoi një fitim pas tatimit prej €45 milionë (€40 milionë në fund të vitit 2022). Më 1 janar 2023, Asdreni sh.a kishte në emetim 20 milionë aksione të zakonshme. Më 1 prill 2023, Asdreni sh.a bëri një emetimin e të drejtave të dy aksioneve të reja për çdo pesë aksione ekzistuese të mbajtura me një çmim prej €3 secila. Çmimi i tregut të aksioneve të zakonshme të Asdreni sh.a menjëherë përpara emetimit ishte €3.50.

Më tej, Asdreni sh.a kishte emetuar një fletëobligacion të konvertueshëm €15 milionë me 6% interes të konvertueshëm në aksione të zakonshme brenda dy vjetësh në bazë të 20 aksioneve për çdo €100 të fletëobligacionit sipas opsionit të mbajtësit të fletëobligacionit. Interesi i fletëobligacionit është i zbritshëm nga tatimet dhe norma tatimore është 30%.

**Kërkohet:**

**Në përputhje me SNK 33 *Fitimet për aksion* shpjegoni dhe llogaritni fitimin themelor dhe të dobësuar për aksion për Asdreni sh.a, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, duke përfshirë fitimin themelor krahasues për aksion për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.**

**(8 pikë)**

(b) Stoqet e Zef Serembe sh.a më 31 dhjetor 2023 përfshin stoqet me një kosto prej €180,000, për të cilat Zef Serembe sh.a mori një ofertë prej €110,000 për shitjen e tyre më 5 janar 2024. Zef Serembe sh.a do të ketë kosto shitje prej €10,000. Shitja është shumë e mundshme. Pasqyrat financiare të Zef Serembe sh.a do të aprovohen për publikim më 30 qershor 2024.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni dhe konstatooni shumën në të cilën stoqet e Zef Serembe sh.a-së duhet të vlerësohet më 31 dhjetor 2023 në përputhje me SNK 2 *Stoqet* dhe SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese*.**

**(4 pikë)**

(c) Më 31 dhjetor 2023, Zef Skiroi sh.a kishte një njësi gjeneruese të parasë që përfshinte pasuritë e mëposhtme:

	€'000
Toka	3,500
Zëri i mirë	1,000
Ndërtesa	4,600
Fabrika dhe makineria	3,300
Stoqet	900
Të arkëtueshmet	<u>980</u>
<b>Total</b>	<b>14,280</b>

Ndërtesa u dëmtua nga të reshurat dhe ishte e papërshtatshme për përdorim. Megjithatë, disa instalime të ndërtesës ishin vlerësuar të kenë një shumë të rikuperueshme prej €500,000. Shuma e rikuperueshme e njësisë gjeneruese të parasë ishte vlerësuar në €7,600,000.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni dhe llogaritni shumën në të cilën do të njihen pasuritë e Zef Skiroi sh.a në njësinë gjeneruese të parasë pas rishikimit të dëmtimit më 31 dhjetor 2023 në përputhje me SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*.**

**(8 pikë)**

**[Total: 20 pikë]**

### Zgjidhje detyra 3.

a) FPA themelore është një masë e shumës së fituar nga një kompani që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm. FPA-ja themelore llogaritet duke pjesëtuar fitimin ose humbjen neto për periudhën që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm me numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme në emetim gjatë periudhës.

Në rastin e Asdreni sh.a, FPA themelore duhet të llogaritet pasi të merret parasysh plotësisht një emetimin i të drejtave. Kjo kërkon nevojën për të llogaritur numrin mesatar të ponderuar të aksioneve; e cila kërkon llogaritjen e çmimi teorik të ish të drejtave si më poshtë:

$$\text{Pjesa para emetimit } 5 \times \text{€}3.5 = \text{€}17.5$$

$$\text{Pjesa e emetimit të ri } \frac{2}{7} \times \text{€}3.0 = \frac{\text{€}6.0}{\text{€}23.5}$$

$$\text{Andaj çmimi teorik të ish të drejtave} = \text{€}3.3571429 (\text{€}23.5/7)$$

FPA për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 = €40,000,000/20,000,000 aksione = €2 për aksion

FPA e riparuar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022:

= FPA x Çmimi teorik i ish të drejtave/ Vlera e drejtë e një aksioni pak para emetimit të të drejtave

$$= \text{€}2 \times \text{€}3.3571429 / \text{€}3.50 = \text{€}1.92 \text{ për aksion}$$

FPA për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023:

Numri mesatar i ponderuar i aksioneve është:

$$\text{Para emetimit të të drejtave: } 20,000,000 \times 3/12 \times 3.5/3.3571429 = 5,212,766$$

$$\text{Pas emetimit të të drejtave: } 28,000,000 \times 9/12 = \underline{21,000,000}$$

$$\text{Total numri mesatar i ponderuar i aksioneve} \quad 26,212,766$$

*Në menyrë alternative:*

$$\text{Emetimi në para} = (8,000,000 \times \text{€}3 / 3.3571429) = 851,064$$

$$\text{Emetimi bonus} = 8,000,000 - 851,064 = \underline{7,148,936}$$
$$8,000,000$$

*Numri mesatar:*

$$\text{Ne fillim} + \text{bonus} (20,000,000 + 851,064) \times 12/12 = 20,851,064$$

$$\text{Te emetuar ne para} (7,148,936 / 12 \times 9) = \underline{5,361,702}$$
$$26,212,766$$

**Andaj, FPA për vitin aktual është €45,000,000/26,212,766=€1.72**

Fitimet para konvertimit të fletëobligacionit janë €45,000,000

Numri mesatar i ponderuar i aksioneve para konvertimit të fletëobligacionit është 26,212,766

Fitimet nga konvertimi €15,000,000 x 6% x 70% = 630,000

Total fitimet e dobësuar për aksione 45,630,000 (45,000,000 +630,000)

Aksionet nga konvertim €15,000,000/€100 x 20 aksione = 3,000,000 aksione

Total aksionet nga konvertimi €29,212,766 (26,212,766+3,000,000)

Andaj, FPA e dobësuar = €45,630,000/29,212,766= **€1.56 për aksion.**

b) SNK 2 *Stoqet* kërkon që stoqet të vlerësohet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme (ose vlerës së drejtë minus kostot për shitje). SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese* kërkon që çdo ngjarje korrigjuese të cilat japin dëshmi për kushtet që kanë ekzistuar në fund të periudhës raportuese të korrigjohen në pasqyrat financiare.

Prandaj, vlera e shitjes së Zef Serembe sh.a për disa prej stoqeve të saj ra në më të ulët se kostoja përpara se pasqyrat financiare të miratoheshin për publikim dhe është një shembull i listuar i një ngjarjeje korrigjuese sipas standardit, prandaj kërkon korrigjim. Duke qenë se kostoja e stoqeve është €180,000; ato duhet të njihen në VNR më të ulët prej €100,000 (€110,000 - €10,000). Stoqet do të zvogëlohen për €80,000 (€180,000-€100,000). Rrjedhimisht, fitimi për vitin do të reduktohet për €80,000

c) SNK 36 *Dëmtimi i pasurive* kërkon që trajtimi i NJGJP-ve të dëmtuara të jetë si më poshtë:

Së pari shpërndarja e humbjes tek pasuria e dëmtuar në mënyrë specifike, i ndjekur nga zëri mirë dhe teprica për pasuritë e mbetura në bazë proporcionale. Në shpërndarjen e humbjes nga dëmtimi, pasuritë qarkulluese duhet të përjashtohen nga shpërndarja pasi SNK 36 *Dëmtimi i pasurive* thotë se vlerat kontabël të tyre zakonisht janë të barabarta me shumatat e tyre të rikuperueshme, pra nuk i nënshtrohen dëmtimit.

NJGJP -ja e Zef Skiroi sh.a u dëmtua pasi shuma e rikuperueshme ishte më e ulët se vlera kontabël me €6,680 (humbje nga dëmtimi).

Humbja do të shpërndahet si më poshtë:

	Vlera bartëse	Humbja nga dëmtimi	Shuma e rikuperueshme
	€'000	€'000	€'000
Ndërtesa	4,600	4,100	500
Emri i mirë	1,000	1,000	0
Tokë	3,500	813	2,687
Fabrika dhe makineria	3,300	767	2,533
Stoqet	900	0	900
Të arkëtueshme	<u>980</u>	<u>0</u>	<u>980</u>
	<b>14,280</b>	<b>6,680</b>	<b>7,600</b>

#### Llogaritjet në €'000

Humbja e paalokuar = 6,680 - 4,100 - 1,000 = 1,580

Pjesa e mbetur e pasurive = 3,500 + 3,300 = 6,800

Proporcioni 1,580 / 6,800 = 23.23%

Toka = 3,500 x 23.23% = 813

Fabrika dhe makineria = 3,300 x 23.23% = 767

4. Sterjo Spasse Plc po konsideron rritjen përmes blerjes së 100% të aksioneve në një kompani kufizuar të përshtatshme. Sterjo Spasse ka marrë pasqyrat financiare të dy objektivave të blerjes që operojnë në të njëjtën industri, Petro sh.a dhe Marko sh.a.

**Pasqyrat e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**

	<b>Petro</b>	<b>Marko</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Shitjet	24,000	41,000
Kosto e shitjes	<u>(21,000)</u>	<u>(36,000)</u>
Fitimi bruto	3,000	5,000
Shpenzimet operative	(480)	(1,000)
Kosto financiare	<u>(420)</u>	<u>(1,200)</u>
Fitimi para tatimit	2,100	2,800
Tatimi në fitim	<u>(300)</u>	<u>(800)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>1,800</b>	<b>2,000</b>
<b>Shënim: dividenda e paguara gjatë vitit</b>	<b>500</b>	<b>1,400</b>

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2023**

	<b>Petro</b>	<b>Marko</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe pajisjet (shënimi (i))	18,800	4,400
Pasuri me të drejtë përdorimi (shënimi (i))	<u>-</u>	<u>10,600</u>
	18,800	15,000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	4,000	7,200
Llogaritë e arkëtueshme	4,800	7,400
Paraja në bankë	<u>1,200</u>	<u>-</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>28,800</b>	<b>29,600</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme €2 secila	4,000	4,000
Teprica e rivlerësimit	1,800	-
Fitimi i mbajtur	<u>5,200</u>	<u>1,600</u>
	11,000	5,600
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Detyrimet ndaj lizingut	-	6,400
Nota kreditore 5%	<u>9,400</u>	<u>6,200</u>
	9,400	12,600
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Akrualet dhe të ardhurat e shtyera	-	3,400
Llogaritë e pagueshme tregtare	6,200	7,600
Tatimi	<u>2,200</u>	<u>400</u>
	<u>8,400</u>	<u>11,400</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>28,800</b>	<b>29,600</b>

**Informata shtesë:**

(i) Vlera fillestare kontabël në lidhje pasuritë jo-qarkulluese janë si më poshtë:

	<b>Petro</b>	<b>Marko</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Prona, fabrika dhe pajisjet	16,000	20,000
Pasuri me të drejtë përdorimi	-	15,000

(ii) Asnjë nga kompanitë nuk e ka shitur/larguar pasuri jo-qarkulluese gjatë vitit.

(iii) Drejtorët e Sterjo Spasse Plc dëshirojnë të kryejnë një analizë financiare krahasuese të dy objektivave të blerjes bazuar në pasqyrat financiare të mësipërme duke përdorur koeficientët e mëposhtëm:

- Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA)
- Kthimi në ekuitet (KNE)
- Qarkullimi i pasurive neto
- Marzha e fitimit bruto
- Marzha e fitimit neto
- Koeficienti i qarkullimit
- Periudha e qarkullimi të stoqeve
- Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme
- Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme
- Hyrja në borxh/leverazhi
- Mbulimi i interesit
- Mbulimi i dividendës

**Kërkohet:**

- (a) Llogaritni koeficientët e mësipërm për Petro sh.a dhe Marko sh.a bazuar në pasqyrat financiare të mësipërme. (10 pikë)
- (b) Përgatitni një raport për Drejtorët e Sterjo Spasse sh.a-së që vlerëson performancën dhe pozitën financiare relative të Petro sh.a-së dhe Marko sh.a-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, duke i këshilluar ata se cili objektivi i blerjes është më i përshtatshëm bazuar në koeficientët e mësipërm. (10 pikë)

[Total: 20 pikë]

## Zgjidhje detyra 4.

(a)

### 1. Rentabiliteti

KNKA = Fitimi para interesit dhe tatimit / (Ekuiteti i aksionarëve plus detyrimet afatgjata) x 100

**Petro sh.a**  $(2,100+420) / (9,400+11,000) \times 100 = 12.35\%$

**Marko sh.a**  $(2,800+1,200) / (12,600+5,600) \times 100 = 21.98\%$

Qarkullimi i pasurive neto = Shitjet / Kapitali i angazhuar

**Petro sh.a**  $24,000 / 20,400 = 1.18$  here

**Marko sh.a**  $41,000 / 18,200 = 2.25$  here

Marzha e fitimit bruto = Fitimi Bruto / Shitjet x 100

**Petro sh.a**  $3,000 / 24,000 \times 100 = 12.5\%$

**Marko sh.a**  $5,000 / 41,000 \times 100 = 12.2\%$

Marzha e fitimit neto = Fitimi neto / Shitjet x 100

**Petro sh.a**  $1,800 / 24,000 \times 100 = 7.5\%$

**Marko sh.a**  $2,000 / 41,000 \times 100 = 4.88\%$

### 2. Likuiditeti

Koeficienti i qarkullimit = Pasuritë qarkulluese / Detyrimet afatshkurta

**Petro sh.a**  $10,000 / 8,400 = 1.19:1$

**Marko sh.a**  $14,600 / 11,400 = 1.28:1$

Periudha e qarkullimi të stoqeve = Stoqet / Kosto e shitjes x 365

**Petro sh.a**  $4,000 / 21,000 \times 365 = 69.5$  ditë

**Marko sh.a**  $7,200 / 36,000 \times 365 = 73$  ditë

Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme = Llogaritë e arkëtueshme tregtare / Shitjet x 365

**Petro sh.a**  $4,800 / 24,000 \times 365 = 73$  ditë

**Marko sh.a**  $7,400 / 41,000 \times 365 = 65.9$  ditë

Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme = Llogaritë e pagueshme tregtare / Kosto e shitjes x 365

**Petro sh.a**  $6,200 / 21,000 \times 365 = 107.8$  ditë

**Marko sh.a**  $7,600 / 36,000 \times 365 = 77.1$  ditë

### 3. Leverazhi

Hyrja në borxh = Borxhi me interes / (Ekuiteti i aksionarëve + borxhi me interes) x 100

**Petro sh.a**  $9,400 / (9,400+11,000) \times 100 = 46.08\%$

**Marko sh.a**  $(6,400+6,200) / (6,400+6,200+5,600) \times 100 = 69.23\%$

Mbulimi i interesit = Fitimi para interesit dhe tatimit / Pagesat e interesit



**Petro sh.a**  $2,520/420 = 6$  here

**Marko sh.a**  $4,000/1,200 = 3.3$  here

#### **4. Investimi i aksionarëve**

KNE = Fitimi pas tatimit dhe dividendes së preferuar/ Fondet e aksionarëve të ekuitetitx100

**Petro sh.a**  $(1,800) / 11,000) \times 100 = 16.36\%$

**Marko sh.a**  $(2,000) / 5,600) \times 100 = 35.71\%$

Mbulimi i dividendës = Fitimi pas tatimit/Dividendat

**Petro sh.a**  $1,800/500 = 3.6$  here

**Marko sh.a**  $2,000/1,400 = 1.43$  here

### **RAPORT**

**Për : Drejtorët e Sterjo Spasse sh.a**

**Nga: Analisti financiar**

**Data : 23 qershor 2023**

**Tema: Performanca dhe pozita financiare relative e Petro sh.a-së dhe Marko sh.a-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.**

#### **1. Hyrje**

Ky raport analizon performancën dhe pozitën financiare të Petro sh.a dhe Marko sh.a duke përdorur analizën e koeficientëve. Fushat e analizës përfshijnë rentabilitetin, likuiditetin, leverazhin dhe performancën nga këndvështrimi i aksionarëve.

#### **2. Rentabiliteti**

Në përgjithësi, Marko sh.a është shumë më rentabil se Petro sh.a, i matur me kthimin në kapitalit të angazhuar (KNKA). KNKA e Marko sh.a-së prej 21.98% është më e lartë se ajo e Petro sh.a-së me vetëm 12.35%. KNKA shihet tradicionalisht si një masë e efikasitetit të përgjithshëm të menaxhimit në përdorimin e kapitalit të disponueshëm (si borxhi ashtu edhe ekuiteti).

Burimi kryesor i rentabilitetit superior të Marko sh.a-së është aftësia për të gjeneruar të ardhura duke përdorur kapitalin e disponueshëm të matur nga qarkullimi i pasurive. Qarkullimi i pasurive të Marko sh.a-së është 2.25 herë, ndërsa ai i Petro sh.a-së vetëm 1.18 herë. Qarkullimi i pasurive të Marko sh.a-së është pra dyfishi i atij Petro sh.a-së.

Marzhet e fitimit të dy kompanive (fitimi bruto dhe fitimi operativ) janë gjerësisht të ngjashëm edhe pse Petro sh.a ka një avantazh në performancën e marzhit të fitimit neto. Mund të ndodhë që Petro sh.a të vendosë çmime më të larta se Marko sh.a ose të ketë kontroll më të mirë të kostos (si kostoja e shitjeve ashtu edhe kostot e tjera operative) se Marko sh.a. Petro sh.a ka fitim bruto dhe marzhë fitimi neto prej 12.5% dhe 7.5% krahasuar me ato të Marko sh.a-së me përkatësisht 12.2% dhe 4.88%.

Si përfundim, Marko sh.a është një objektivi blerjeje më i mirë se Petro sh.a për sa i përket rentabilitetit.

#### **3. Likuiditeti**

Të dyja kompanitë duket se kanë likuiditet relativisht të ulët të matur me koeficienti i qarkullimit. Të dy Petro sh.a dhe Marko sh.a kanë afërsisht të njëjtin raport aktual prej 1.19 dhe 1.28 respektivisht, megjithëse Petro sh.a është në një pozitë më të mirë me një bilanc të parave prej €1.2 milionë në bankë ndërsa Marko sh.a ka një saldo bankare prej €0. Në këtë drejtim, politika e Marko sh.a-së për pagesa të larta dividendësh (që çon në një mbulim të ulët të dividendit dhe fitime të ulëta të pashpërndara) është shumë e diskutueshme.

Duke parë më në thellësi, të dyja kompanitë kanë ditë të ngjashme të stoqeve; Marko sh.a i mbledh të arkëtueshmet një javë më herët se Petro sh.a (ndoshta procedurat e kontrollit të kredisë janë më aktive për shkak të mungesës në para), dhe ndryshimi i dukshëm është se Petro sh.a merr një periudhë shumë më të gjatë kredie nga furnitorët e saj (107.8 ditë krahasuar me 77.1 ditë). Ky mund të jetë një reflektim i faktit se Petro sh.a është në gjendje të negociojë kushte më të mira kredie për shkak të një vlerësimi më të lartë kreditor.

#### **4. Leverazhi dhe investimi i i aksionarëve**

Nga koeficienti i leverazhit mund të shihet se 69.23% e pasurive të Marko sh.a-së financohen nga huamarrje me financim të konsiderueshëm të pasurive nëpërmjet lizingut. Kjo është shumë e lartë në terma absolutë dhe rreth 1.5 here me shumë se niveli i leverazhit të Petro sh.a-së (vetëm 46.08%). Efekti i leverazhit të lartë të Marko sh.a-së është një kthim më i lartë në ekuitet (KNE). Edhe pse kjo mund të duket e dobishme për aksionerët e Marko sh.a-së, por nuk është pa rrezik. Mbulimi i interesit të Marko sh.a-së është vetëm 3.3 herë, ndërsa mbulimi i ulët i interesit të Marko sh.a-së është pasojë e drejtpërdrejtë e leverazhit të tij të lartë dhe i bën fitimet të prekshme ndaj ndryshimeve relativisht të vogla në pasuritë për shembull, reduktime të vogla në shitje, marzhe fitimi ose rritje të vogla në shpenzimet operative mund të rezultojnë në humbje dhe të nënkuptojnë që shpenzimet e interesit nuk do të mbulohen.

#### **5. Konkluzion**

Megjithëse të dyja kompanitë mund të operojnë në një industri të ngjashme dhe të kenë fitime të ngjashme pas tatimit, ato do të përfaqësonin blerje shumë të ndryshme. Të ardhurat e Marko sh.a-së nga shitjet janë mbi 70% më shumë se ato të Petro sh.a-së, financohet nga nivele të larta borxhi, dhe zgjedh të marrë me qira në vend që të blejë pasuri jo-qarkulluese. Nëse Marko sh.a do të zëvendësojë fabrikën në pronësi në fund të jetës së dobishme, zëvendësimi i tij ose do të kërkojë një injeksion parash nëse do të blihet ose do të krijojë nivele edhe më të larta të leverazhit nëse vazhdon politika e leasing-ut. Me pak fjalë, megjithëse kthimi i përgjithshëm i Marko sh.a-së duket më tërheqës se ai i Petro sh.a-së, ai do të përfaqësonte një investim shumë më të rrezikshëm. Në fund të fundit, vendimi i investimit mund të përcaktohet nga qëndrimi i Sterjo Spasse sh.a-së ndaj rrezikut, sinergjitë e mundshme me aktivitetet e tij ekzistuese të biznesit, dhe jo më pak e rëndësishme, nga çmimi i kërkuar për çdo investim.

5. Më poshtë janë paraqitur pasqyrat financiare të Pashko Vasa sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

**Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023**

	<b>€'000</b>
Të ardhurat	1,034,300
Kosto e shitjeve	<u>(908,760)</u>
Fitimi bruto	125,540
Shpenzimet operative	<u>(105,460)</u>
Fitimi nga operacionet	20,080
Kosto financiare	<u>(8,090)</u>
Fitimi para tatimit	11,990
Tatimi në fitim	<u>(6,720)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>5,270</b>

**Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2023**

	<b>2023</b>	<b>2022</b>
<b>Pasuritë</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	161,040	139,180
Prona investuese	10,000	11,000
Pasuritë e paprekshme	<u>14,390</u>	<u>17,650</u>
	185,430	167,830
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	98,310	83,800
Të arkëtueshmet	54,290	48,920
Investimet	10,000	10,000
Paraja	<u>26,580</u>	<u>65,180</u>
	<u>189,180</u>	<u>207,900</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>374,610</b>	<b>375,730</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	4,500	4,000
Premia e aksioneve	16,000	15,000
Fitimet e mbajtura	<u>88,510</u>	<u>88,240</u>
	109,010	107,240
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
18% Kredi bankare – Banka A	-	18,560
15% Kredi bankare – Banka B	79,430	-
Tatimi i shtyrë	<u>2,340</u>	<u>1,080</u>
	81,770	19,640
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	144,490	232,070
Mbitërheqja bankare	21,230	-
Tatimi	3,000	2,500
Provizionet për garancione	<u>15,110</u>	<u>14,280</u>
	<u>183,830</u>	<u>248,850</u>
	<b>374,610</b>	<b>375,730</b>

**Informata shtesë:**

- (i) Investimet e paraqitura në pasuritë qarkulluese janë obligacione qeveritare dhe menaxhmenti ka vendosur t'i klasifikojë ato si ekuivalente të parasë.
- (ii) Nuk ka pasur as blerje dhe as nxjerrje jashtë përdorimit të pasurivë të paprekshme dhe pronës investuese gjatë vitit.
- (iii) Pashko Vasa sh.aka një politikë garancie një vjeçare për shumicën e produkteve që shet. Shumat e paraqitura si provizion për garancinë janë një vlerësim i saktë, bazuar në përvojën e kaluar, të shumës së pretendimeve që mund të bëhen në lidhje me garancitë e papaguara në çdo fund viti. Kostot e garancisë përfshihen në koston e shitjes.
- (iv) Pashko Vasa sh.a nuk bëri asnjë emetim bonus, por emetoi aksione shtesë të kapitalit për para në dorë më 1 tetor 2023.
- (vi) Për shkak të politikave të favorshme makroekonomike në vend, normat e huadhënies bankare pësuan rënie në vitin 2023 dhe menaxhmenti i Pashko Vasa sh.a shfrytëzoi një mundësi për të ristrukturuar kreditë bankare.
- (vii) Lëvizja e vlerës së drejtë në pronën investuese, e matur me vlerën e drejtë është përfshirë në shpenzimet operative.
- (viii) Gjatë vitit, Pashko Vasa sh.a shiti një zë të fabrikës me vlerë kontabël prej €9,650,000 me humbje prej €500,000.
- (ix) Zhvlerësimi prej €23,950,000 ishte ngarkuar në shpenzimet operative për pronën, fabrikën dhe pajisjet në vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

**Kërkohet:**

- (a) Përgatitni një pasqyrë të rrjedhave të parasë për Pashko Vasa sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 në pajtim me SNK 7 Pasqyra e rrjedhave të parasë duke përdorur metodën indirekte. (18 pikë)
- (b) Shpjegoni pse është e rëndësishme që kompanitë të identifikojnë rrjedhat e parasë të gjeneruara nga operacionet kur vlerësojnë likuiditetin e ardhshëm? (2 pikë)

[Total: 20 pikë]

## Zgjidhje detyra 5.

### Pashko Vasa sh.a

#### Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023

	€'000
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>	
Fitimi para tatimit	11,990
Kosto financiare	8,090
Zhvlerësimi	23,950
Amortizimi i pasurive të paprekshme (14,390 - 17,650)	3,260
Rritja në provizionet për garancione (15,110 - 14,280)	830
Humbja nga vlera e drejtë në pronën investuese (10,000 - 11,000)	1,000
Humbja nga shitja e fabrikës	<u>500</u>
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në KQ	49,620
Rritja në stoqe (98,310 - 83,800)	(14,510)
Rritja në të arkëtueshmet (54,290 - 48,920)	(5,370)
Rënia në të pagueshmet (144,490 - 232,070)	<u>(87,580)</u>
Paraja e përdorur në operacione	(57,840)
Interesi i paguar	(8,090)
Tatimi i paguar (L11)	<u>(4,960)</u>
<b>Neto paraja e përdorur në aktivitetet operative</b>	<b>(70,890)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>	
Blerja e fabrikës (L12)	(55,460)
Shitja e fabrikës (9,650 - 500)	<u>9,150</u>
<b>Neto paraja e përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(46,310)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>	
Arkëtimet nga emetimi i aksioneve (L13)	1,500
Arkëtimet nga kredia në bankën B	79,430
Pagesa e kredise në bankën A	(18,560)
Dividenda e paguar (L14)	<u>(5,000)</u>
<b>Neto rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>57,370</b>
Neto zvogëlimi në paranë dhe ekuivalentët e parasë	(59,830)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim (10,000 + 65,180)	<u>75,180</u>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund (26,580 + 10,000 - 21,230)</b>	<b>15,350</b>

(b) Paraja e gjeneruar nga operacionet është një burim i qëndrueshëm parash. Nëse një kompani do të vazhdojë të tregtojë në të njëjtën bazë siç bën aktualisht, një nivel i ngjashëm parash do të gjenerohet në të ardhmen. Kjo është në kontrast me paratë e marra nga emetimet e aksioneve, marrja e kredisë ose shitja e pasurive; këto janë burime të paqëndrueshme parash, sepse aksionet ose kreditë nuk mund të emetohen çdo vit dhe pasuritë nuk mund të shiten çdo vit nëse një biznes do të vazhdojë tregtimin.

Paratë e gatshme nga operacionet duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar pagesat e detyrueshme të interesit dhe tatimeve; nëse nuk është kështu, një kompani mund të ketë probleme likuiditeti. Çdo para e tepërt është në dispozicion për shpenzime diskreionale, siç është pagesa e dividendëve.

## Llogaritjet

### 1. Tatimi i paguar

<b>Debi</b>	<b>€'000</b>	<b>Kredi</b>	<b>€'000</b>
Paraja e paguar (Saldo balancuese)	4,960	Saldo ne fillim -Tatimi aktual	2,500
Saldo në fund - Tatimi aktual	3,000		
Tatimi i shtyrë	<u>2,340</u>	Tatimi i shtyrë	1,080
	<b>10,300</b>	P e F/H	<u>6,720</u>
			<b>10,300</b>

### 2. Pasuritë jo-qarkulluese

<b>Debi</b>	<b>€'000</b>	<b>Kredi</b>	<b>€'000</b>
Saldo ne fillim	139,180	Largimet	9,650
Paraja e paguar (Saldo balancuese)	<u>55,460</u>	Zhvlerësimi	23,950
	<b>194,640</b>	Saldo në fund	<u>161,040</u>
			<b>194,640</b>

### 3. Ekuiteti dhe premia e aksioneve

<b>Debi</b>	<b>€'000</b>	<b>Kredi</b>	<b>€'000</b>
Saldo në fund - KA	4,500	Saldo në fillim - KA	2,500
- PA	16,000	- PA	15,000
	<u>20,500</u>	Paraja e pranuar	<u>1,500</u>
			<b>20,500</b>

### 4. Fitimet e mbajtua

<b>Debi</b>	<b>€'000</b>	<b>Kredi</b>	<b>€'000</b>
Dividenda e paguar (Saldo balancuese)	5,000	Saldo në fillim	88,240
Saldo në fund	<u>88,510</u>	Fitimi i vitit	<u>5,270</u>
	<b>93,510</b>		<b>93,510</b>